REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**
**SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR**

Nr.1259, prot                                                    Tiranë, më 21/09/2020

**URDHËR**

**Nr. 178, datë 21.09.2020**

**MBI**
**ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 597, DATË 4.09.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËSMUJORE TË PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE PËRDORIMIT TË FONDIT SHTESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR PËR NDIHMËN EKONOMIKE"**

Bazuar në Kreun III, neni 12, pika 8 e ligjit nr.57, 18.07.2019, "Për Asistencën Sociale në RSH", të pikës 2, Kreu III, të VKM nr. 597, datë 4.09.2019, "Për përcaktimin e proçedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe VKM nr 135, datë 7.03.2018, "Për miratimin e Statusit të Shërbimit Social Shtetëror"

**URDHËROJ:**

1. Masa e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë përcaktohet sipas strukturës së familjes dhe shkon deri në 11.511 (njëmbëdhjetëmijë e peseqind e njëmbëdhjetë) lekë në muaj.

2. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhëri, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2020 dhe përballohet me fondet e akorduara për vitin 2020.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efeket financiare nga 01.09. 2020.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR - TIRANË - MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Luneda Sufali**